



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Administratës Zgjedhore

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN

PËR

NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 5.12.2020, TË KOMISIONIT
RREGULLATOR, "PËRCAKTIMI I RREGULLAVE PËR NGRITJEN, CAKTIMIN DHE
NJOFTIMIN E VENDNDODHJES SË QENDRAVE TË VOTIMIT DHE PËRGATITJEN E
HARTËS SË NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE PËR ZGJEDHJET", TË
NDRYSHUAR

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Referuar nenit 20, pika 1, shkronjat "e" dhe "ë" dhe nenit 22, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, parashikohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektakte me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, lidhur me rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyra të administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje.

II. PËRMBLEDHJE SHPIEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Udhëzimi Nr. 1/2020 ka si qëllim përcaktimin e rregullave që do të ndiqen nga organet e njësisë së qeverisjes vendore për caktimin e zonave dhe vendndodhjes së qendrave të votimit në përputhje me parashikimet e ligjit 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Në nenin 5 janë përcaktuar kriteret teknike dhe pajisjet që duhet të ketë qendra e votimit ku ndër të tjera parashikohet edhe marrja e masave për të pajisur qendrën e votimit me pajisje sipas skemës tip të plan vendosjes. Kjo skemë tip e miratuar me këtë udhëzim lidhet me procesin e zgjedhjeve për Kuvend dhe nuk është parashikuar një skemë tip plan vendosje për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Duke qenë se në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore votohet me dy kuti votimi, njërën për kryetar bashkie dhe një kuti tjetër votimi për këshillin e bashkisë, diktohet nevoja për paraqitjen edhe një të skeme tip plan vendosje për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, i propozojnë Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim, projektvendimin "Për një shtesë në udhëzimin nr.1, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator, "Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e



vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, i ndryshuar.

Erion META Drejtorja e Administratës Zgjedhore
Majlinda ÇELMETA Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve
Ylli MERKAJ Sekretar i Përgjithshëm





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: .4.2023 | Nr: | Ora:

PROJEKT VENDIM

PËR

**NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 5.12.2020, TË KOMISIONIT RREGULLATOR,
“PËRCAKTIMI I RREGULLAVE PËR NGRITJEN, ÇAKTIMIN DHE NJOFTIMIN E
VENDNDODHJES SË QENDRAVE TË VOTIMIT DHE PËRGATITJEN E HARTËS SË NJËSISË SË
VETËQEVERISJES VENDORE PËR ZGJEDHJET”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 20, pikat 1, shkronjat “a” e “b”, dhe 3, nenit 22, pika 3, dhe nenit 36 e vijues, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

1. Në udhëzimin nr. 1, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar, bëhet shtesa si më poshtë vijon:
 - a) në fund të shkronjës “a” të pikës 3, të nenit 5 shtohet fjalia si vijon:
-“Të njëjtat masa merren edhe për zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore, sipas skemës tip, të planvendosjes, bashkëlidhur këtij udhëzimi”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të behet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar

Data: .4.2023 Nr:
Ora:



“Për një shtesë në udhëzimin nr. 1, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, çaktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, të ndryshuar”